


Fejton: “Shpërbërja e Jugosllavisë” (12)

Ringjallja

Kriza nuk nënkuptonte automatikisht edhe luftën. Për t’i futur në luftë vëllavrasëse njerëzit që kishin lidhje fqinjësie, fafëfisnie, miqësie e partneriteti, duhej një strategji e kujdesshme: duheshin resurse njerëzore, e mbi të gjitha para

Në fillim të viteve ‘80, figurat udhëheqëse në parti tërheqnin vërejtjen për rrezikun e “libanizimit”, në fund të 80-ve, tërhiqnin vërejtjen për krizën dhe tashmë rreziku i shkrirjes kishte zënë vend në Jugosllavi. Shkatërrimi i ekonomisë ishte një forcë shtytëse në këtë ekua-cion vdekjeprurës. Gjatë viteve 1981-88, të ardhurat për kokë banori zvogëloheshin çdo vit përveç vitit 1984 (kur nuk pati rritje) dhe vitit 1986. Për tetë vjet prodhimi bujqësor bruto pati katër herë rënie, ndërsa prodhimi bruto në industri ishte i pasigurt. Me një fjalë, Jugosllavia ishte zhytur në krizë ekonomike - krizë kjo që reflektonte në rritjen e borxheve të jashtme, rritjen e papunësisë dhe të inflacionit. Njerëzit gjetën mënyra për të zvogëluar shpenzimet, p.sh. duke mos e paguar energjinë elektrike dhe vërshonin rrugët me protesta. Vendi po rrëshqiste drejt një kolapsi të hapët ekonomik dhe qytetarët të cilët ishin pajtuar të

jetojnë në sistemin njëpartiak, tashmë u ngopën. Revistat si “NIN”, “Duga”, “Start”, “Zum reporter”, “Mladina” dhe “Svijet” i mbushnin faqet e tyre me artikuj dhe intervista në të cilat pranohej kriza e thellë dhe kërkonin ndryshime. Në Slloveni dhe Kroaci murmuritej se atyre u ishin prerë teshat për shumicën e borxheve të këqija të akumuluar nga Jugosllavia. Disa figura udhëheqëse në parti madje e pranonin se vendi po rrëshqet në një krizë politike e madje edhe morale. Mirëpo, kriza nuk nënkuptonte automatikisht edhe luftën. Për t’i futur në luftë vëllavrasëse njerëzit që kishin lidhje fqinjësie, fafëfisnie, miqësie e partneriteti, duhej një strategji e kujdesshme: duheshin resurse njerëzore, e mbi të gjitha para. Siç u mësua më vonë, Milosheviqi grumbulloi 151 milionë dollarë nga serbët e diasporës gjoja si kredi për rindërtimin e Serbisë. Ndonëse



kjo fushatë supozohej se bëhej me qëllime ekonomike, të hollat mbaruan në arkën e luftës. Në këtë rrafsh në Serbi u shfaq lëvizja për revitalizimin e definuar si “përpjekje e organizuar, e kujdesshme, e vetëdijshme e anëtarëve të shoqërisë për të ndërtuar kulturë më të kënaqshme”. Duke e quajtur lëvizjen e ringjalljes kombëtare serbe si “lëvizje të revitalizimit”, supozojmë se kishte diçka të përbashkët me lëvizjet e llojeve të tjera, përfshirë kultet fetare dhe eksperimentet utopiste. Të gjitha këto fenomene kishin të njëjtnë dinamikë. Revitalizimit vazhdimisht i paraprinte periudha e stresit individual dhe

shoqëror, duke e arritur shkallën kur individët në fjalë dhe shoqëria në përgjithësi filloi ta konsiderojë të papranueshëm. Si rezultat, supozimet e ngritura dhe mënyrat si kryheshin punët u braktisën (në procesin e quajtur “shtrembërim kulturor”) duke ngritur kështu edhe më shumë “lëvizjen e ringjalljes”. Natyrisht se disa lëvizje revitalizimi mund të dështojnë, kështu që lëvizja e ringjalljes kombëtare serbe dëshmoi se ishte një dështim i pjesërishtëm: dështoi në arritjen e qëllimeve territoriale në Kroaci dhe Bosnjë-Hercegovinë, por pati sukses në transformimin e kulturës politike në Serbi.

“Shpërbërja e Jugosllavisë” është raport i përpiluar nga projekti “Iniciativa e intelektualëve”, rreth të cilit janë mbledhur historianë të shumtë nga Ballkani dhe mbarë bota për të hulumtuar gjenezën e konfliktit në ish-Jugosllavi. Ky projekt ka punuar në disa grupe të ndara, të cilat kanë trajtuar aspekte të ndryshme dhe kanë përpiluar raporte të veçanta. Grupi që ka punuar raportin rreth “Shpërbërjes së Jugosllavisë” është udhëhequr nga Sabrina Ramet dhe Latinka Perović. Për shkak të hapësirës, “Koha Ditore” e boton si fejton një variant të shkurtuar të raportit.

(Në numrin e nesërm: Sllovenët ankohen për taksat e larta, shqiptarët për moszhvillimin e vazhdueshëm të krahinës, punëtorët në Kroaci hedhen në grevë me kërkesën për rritje të pagave, serbët e Kosovës kërkojnë mbrojtje në Beograd)

Fejton: “Sekretet e spiunazhit botëror” (12)

Si e shpëtuan spiunët botën nga lufta e tretë botërore

Koha e Luftës së Ftohtë ishte kohë bastesh të mëdha. Me dy fuqitë botërore të vendosura ta asgjësojnë njëra-tjetrën me një prekje pulle, puna e spiunëve ishte që të mbledhin informata të mjaftueshme për t’i mbajtur tensionet nën kontroll që të mos eskaloni përtej pikës së fundit

Në spiunazh, përfitimi shpesh u shkon atyre që më së miri i shfrytëzojnë dëshirat dhe dobësitë njerëzore, diç që Markus Wolf e ka ditur shumë mirë. Nga zyra e tij në Berlin, Wolf sajonte skemën e tij të infiltrimit të “Romeo spiunëve” në mbarë Evropën Perëndimore. Këta ishin burra, sikur Roland G., që ngashënjenin femrat që punon punë të ndjeshme ashtu që të fitojnë qasje në informata sekrete. Këta agentë i prodhuan disa nga fitoret më të mëdha të zbulimit të Lindjes. Koha e Luftës së Ftohtë ishte kohë bastesh të mëdha. Me dy fuqitë botërore të vendosura ta asgjësojnë njëra-tjetrën me një prekje pulle, puna e spiunëve ishte që të mbledhin informata të mjaftueshme për t’i mbajtur tensionet nën kontroll që të mos eskalojnë përtej pikës së fundit. Informatat më të vlefshme ishin ato për vendosjen e forcave ushtarake të NATO-s dhe Paktit të Varshavës dhe rreth aresnalit nuklear të secilës palë. Me qëllim që të siguroj këso informata kritike, CIA ndërmori

operacionin e saj më të guximshëm të kohës së Luftës së Ftohtë në Berlin: ndërtimin e një tuneli nën qytet për të përgjuar lidhjet ushtarake sovjetike. Më 1954, nga një ndërtesë e papërshkruar në sektorin amerikan të qytetit të maskuar si stacion radari, SHBA-ja dhe Britania nisën gropimin e asaj që do të bëhet tunel prej një çerek milje në sektorin sovjetik. Kur puna u krye një vit më vonë, aleatët nisën përgjimin e një morie kabllorësh nëntokësorë që e lidhnin shtabin e ushtrisë sovjetike në Berlin me Moskën. Por, ajo që CIA në Berlin nuk e dinte ishte se KGB-ja dinte për tunelin që nga fillimi. Informata sovjetikëve u erdhi nga George Blake, një agent i KGB-së me pozitë të lartë në shërbimin britanik MI-6. Por, për fat të mirë të Perëndimit, edhe pasi që Blake ia kaloi informatën KGB-së lajmi për tunelin kurrë nuk u përcoll deri tek Ushtria sovjetike. Zbulimi i Blakeut e kishte vënë KGB-në ara dilemës: ose ta bëjë publike informatën për tunelin

dhe kështu të rrezikojë zbulimin e spiunit të saj Blake, ose të lejojë Perëndimin që të vazhdonte përgjimin e lidhjeve ushtarake sovjetike dhe të rrezikojë zbulimin e sekreteve shtetërore. KGB-ja zgjodhi ta mbrojtë Blakeun. Dikur, sovjetikët e inskenuan zbulimin “aksidental” të tunelit, por jo para se përgjimi amerikano-britanik të incizonte 443,000 biseda sovjetike dhe gjermanolindore, prej të cilave shumë kishin të bëjnë me funksionimin e brendshëm të aleancës lindore ushtarake. Lojërat berlinase të spiunazhit kanë prodhuar edhe heronj edhe horra, por puna që është bërë nën hijen e Evropës Qendrore shpesh ishte kritike për t’i përmbytur Washingtonin dhe Moskën nga zhytja në luftën e tretë botërore. Në një luftë që zgjati katër dekada, por nuk shënoi asnjë betejë të madhe, spiunët janë përdorur ashtu që ushtarakët të mos përdoren. Për shembull, sipas dokumenteve të bëra publike së voni, Baza e CIA-s për Operacione në



Selia e shërbimit sekret të zbulimit britanik në Vauxhall

Berlin i kishte raportuar presidentit amerikan Harry Truman më 1948 se forcat sovjetike nuk ishin të gatshme ta sulmonin Perëndimin gjatë bllokadës së Berlinit atë vit, gjë që i lejoi Trumanit ta dërgojë një mesazh të matur si përgjigje. Sa për njerëzit si Markus Wolf, sa më shumë informata që zbulonin për Perëndimin aq më pak ishin të bindur për mbijetesën e sistemit të tyre. E megjithatë, sikur ushtarët, ata vazhduan të kryenin punën e tyre përgjatë

asaj që Wolf e quan “front i padukshëm”. “Rreziqet ishin shumë të mëdha”, thotë Wolf sot. “Dhe nëse spiunët zbuloheshin, ata kanë mundur ta humbasin lirinë e tyre për një kohë të gjatë. Ose, kanë mundur ta humbasin jetën sikurse ushtarët”.

(Nesër: Çfarë eksperimentesh psikike bënte CIA në vitet 70? Si është përdorur parapsikologjia për spiunim?)